



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## TË DHËNAT MBI NDËRMARRJEN

<b>Emri i NSH-së:</b>	<b>KBI “Agrokultura” Gjilan, (“Ndërmarrja”)</b> PIP “Mladost” Gnjilane,
<b>Emri i Ndër së Re:</b>	<b>Ndërmarrja e Re Industria e Mishit Agrokultura Sh.P.K</b> (“Ndërmarrja e Re”)
<b>Vendndodhja:</b>	Fshati Velekincë në Komunën e Gjilanit
<b>Biznesi/Spektori:</b>	Industria Agro Ushqimore
<b>Prodhimet:</b>	<p>Veprimtaria kryesore e Ndërmarrjes së Re është prodhimi dhe përpunimi i mishit dhe nënprodukteve të tij. Subjekti i ri është një industri e tërë në kuptimin e plotë të fjalës e cila në vetvete përmban të gjitha hallkat e zinxhirit agro ushqimor që nga stalla e kafshëve, therja, përpunimi, ambalazhimi, ruajtja dhe deponimi i produkteve, e deri tek shitja. Edhe pse e dizajnuar dhe e ndërtuar kohe me parë kjo industri është shumë bashkëkohore për sa i përket plotësimit të standardeve të BE për ndërtesat dhe dizajnimin e rrjedhjes së produktit duke mos lejuar kontaminimin e ndërsjellët, për vetëkontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore duke qenë i pajisur me laboratorin (mikrobiologjik, kimik dhe fiziko-kimik).</p> <p>Kjo Ndërmarrje e Re posedon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Linjën e therjes së shpezëve, me kapacitet 2500-3000 biba ose 8000 zogë pule në një ndërrim (8 orë pune)</li><li>• Repartin për përpunimin e mishit: Linja e prodhimit të: sallameve, suxhuk, proshutë/mishra të thate, konserva të ndryshme dhe linja e hamburgerëve.</li><li>• Linja e therjes së kafshëve të trasha me kapacitet 40 frymë për një ndërrim pune.</li><li>• Linja e therjes së kafshëve të imëta, me kapacitet 600 qengja në një ndërrim.</li><li>• Fabrikën e përpunimit të eshtrave dhe mbetjeve organike – për prodhimin e koncentratit.</li></ul> <p>Produktet kryesore janë: biba, zogj, mish, të freskëta dhe të ngrira, mish i konservuar, suxhuk dhe sallame, mish i terur dhe “brumë” për hamburgerë.</p>
<b>Tregu:</b>	Ndërmarrja e Re ofron fabrikën për përpunimin e mishit dhe duke marrë parasysh këtë, ajo mund të konsiderohet si një mundësi e shkëlqyer për eksportin e mishit dhe nënprodukteve të tij në të ardhmen si dhe mund të furnizojë me prodhimet e veta tregtarët me shumicë dhe pakicë, mishtoret vendore si dhe restorantet.

Rr. E Bujanovcit PN  
(f-ika baterive IBG)  
60 000 Gjilan, Kosovë,  
Tel: 0280 328 444,  
Fax: 0280 326 000  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Konkurrenca:** Konkurrent te kësaj Ndërmarrje te re mund te konsiderohen industritë e mishit te nivelit: FLOREN, EHW, KMY, PILIC etj si këto. Edhe pse ne Kosove ne përgjithësi edhe ne Gjilan me rrethine ekzistojnë disa mishore por për nga linjat e përpunimit dhe kapaciteti i prodhimit janë te papërfillshme ne krahasim me Subjektin e Ri.

**Punonjësit:** Ndërmarrja për momentin ka katër punëtorë. Sidoqoftë, asnjëri nga këta punëtor nuk do të bartet tek Ndër e Re.

**Ndërtesat dhe tokat:** Prona ne fjalë përbëhet nga toka qe përfshin parcelat me nr. P-70403006-00216-2, P-70403006-00217-2, P-70403006-00248-0, P-70403006-00249-0, P-70403006-00250-0, P-70403006-00251-1, P-70403006-00252-0, P-70403006-00253-0, P-70403006-00254-1, sipas certifikatës nr. 103, Zona kadastrale Velekincë, komuna e Gjilanit. Hapësira totale e tokës është rreth 57239m<sup>2</sup> (5ha 72ari 39m<sup>2</sup>).

Për sa i përket ndërtesave subjekt i kësaj shitjeje jepet përshkrimi tabelar si me poshtë:

Objekti	Hapësira ne m <sup>2</sup>	Nr I kateve	Totali m <sup>2</sup>
Objekti te rezervuari I ujit	51	Përdhese	51
Objekti I rojes/sigurimit	95	Përdhese	95
Rezervuari I Ujit	71		71
Therja e shpezëve, reparti i përpunim. te mishit	4491	Përdhese	4491
Ndërtesa e Admin. dhe laborator	750	P+1	1500
Vija e therjes se kafshëve te trasha	1326	Përdhese	1326
stalla/Ahëri	393	Përdhese	393
Impianti I trajtimit te ujerave te zeza	237	Përdhese	237
Pastrimi, dezinfkt. I auto mjeteve	126	Përdhese	126
Depoja e ngrohtores	575	Përdhese	575
Ngrohtorja	334	P+2	1002
Fabrika e perpun. te eshtrave	316	P+2	948
		<b>Totale</b>	<b>10815</b>

Rr. E Bujanovcit PN  
(f-ika baterive IBG)  
60 000 Gjilan, Kosovë,  
Tel: 0280 328 444,  
Fax: 0280 326 000  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**Detyrimet që do të barten:**

- (1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjokat, të cilat janë krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, e që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
- (4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:
  - a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
  - b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

**Fotoja e Ndërmarrjes së Re**

**Ndërmarrja e Re Industria e Mishit Agrokultura Sh.P.K**



**Informatat:**

Departamenti i Shitjes

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255

Fax: + 381 (0) 38 248 076

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

**Dokumentet e Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr.8

10000 Pristinë, Kosovë

Rr. E Bujanovcit PN  
(f-ika baterive IBC)  
60 000 Gjilan, Kosovë,  
Tel: 0280 328 444,  
Fax: 0280 326 000  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)